



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.23/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në lëndën disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore _____ dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të LPP-së, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike me datën 30.12.2020, në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, palës ankuese _____ dhe përmbaruesi privat, _____ pas mbajtjes së seancës së këshillimit ane votimit të mbajtur me datën 30.12.2020, Komisioni me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat : _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, _____ shqiptohet masa disiplinore "gjobë në të holla," në shumën prej 500 € (pesëqind Euro) e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.3 të LPP-së.
- III. Detyrohet përmbaruesi privat, _____ të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një (1) muaji duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi përmbaruesit privat.

Arsyetim

Me datën 29.10.2020, pala ankuese- ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat . si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore i për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të LPK-së. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat i ka bllokuar llogarinë bankare. Pala ankuese thekson se asnjëherë nuk ka nënshkruar faturë për shërbime nga kolegji "ILIRIA." Tutje, thekson se urdhëri përmbarimor P.nr 1366/20 i datës 22.09.2029 është lëshuar në bazë të një fature të parregullt dhe borxhit të parashkruar.

Me datën 09.11.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore- e, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të LPP-së.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që shkresat i janë dorëzuar palës ankuese siç mund të vërtetohet edhe nga fletëkthesa e Postës së Kosovës në mënyrë të rregullt por i njëjti ka refuzuar pranimin. Kurse lidhur me kontestimin e dokumentit përmbarues, përmbaruesi privat thekson se, bazuar në nenin 5 par 5 të LPP, kompetente për adresimin e një pretendimi të tillë është gjykata. Për këto arsye, përmbaruesi privat kërkon që Komisioni të refuzoj ankesën e parashkruar nga pala ankuese, si të pabazuar.

Me datën 25.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përmbaruesi privat, dhe pala ankuese-

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përmbaruesit privat : duke theksuar se bazuar në pretendimet e palës ankuese të paraqitura me shkrim përmbaruesi privat i ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të LPP me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore.

Përmbaruesi privat gjatë seancës ka paraqitur qëndrimin e tij se pretendimet e palës ankese nuk janë të bazuar prandaj ka kërkuar nga Komisioni ta refuzoj atë. Kurse pala ankuese ka ngelur pranë qëndrimeve të tij dhe në Komision ka paraqitur me shkrim deklarinë e tij lidhur me pretendimet për shkelje disiplinore nga ana e përmbaruesit privat.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: propozimin për përmbarim dt 21.09.2020; email nga dt 20.07.2020; Fatura dt 12.02.2020; prapësimi dt 28.10.2020; kërkesa në kolegjin Iliria d 06.11.2020; Urdhëri për përmbarim dt 22.09.2020; Dërgesa e Urdhërit dt 25.09.2020; Aktvendimi PPP 774/19 dt 03.06.2019 dhe komunikimet elektronike.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë që përbaruesi ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni gjen se përbaruesi privat kishte vepruar në kundërshtim me ligjin duke tejkaluar autorizimet e tij ligjore me rastin e zbatimit të përbarimit mbi bazën e një fature të tillë. Nuk është kontestuese që gjykata është kompetente për vlerësimin e rregullsisë së dokumentit përbarues. Megjithatë, çështja e cila shtrohet pranë komisionit nuk është lidhur me vlefshmërinë e dokumentit përbarimor. Çështja e vlefshmërisë së faturave të lëshuara nga kolegjet private është adresuar në një numër të madh lëndësh nga ana e gjykatave në Republikën e Kosovës. Gjykatat kanë ardhur në përfundim se faturat e përpiluara nga ana e Kolegjeve Private nuk plotësonin kërkesat ligjore për përbarueshmëri. Edhe Gjykata e Apelit¹ kishte theksuar që “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa duke pasur parasysh edhe nenin 20 par 1.1.17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën tatimore dhe procedurat i cili përcakton ‘në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore,’ ” gjykata kishte ardhur në përfundim se fatura e bashkangjitur propozimit për përbarim nuk i përmbushë të gjitha kushtet e parapara ligjore. Kjo faturë e lëshuar nga Kolegji “Iliria”, në rastin konkret nuk bënë asnjë përjashtim. E njëjta është lëshuar pas shumë vitesh për shërbime të mëhershme dhe nuk e përmban nënshkrimin e palës debitore. Komisioni gjen se edhe përbaruesi ishte në dijeni për vendimet e gjykatave edhe pse pretendon se ka vendime të cilat i kanë pranuar si të rregullta edhe faturat të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e palës debitore. Komisioni nuk ka asnjë provë ku ndonjë gjykatë në Republikën e Kosovës të ketë pranuar kështu lloj faturash të lëshuara nga Kolegjet private si të rregullta. Rrjedhimisht, veprimi i përbaruesit mbi bazën e një fature të tillë duke qenë në dijeni se të njëjtat nuk janë të rregullta sipas vlerësimit nga gjykatat, është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Për sa i përket pretendimeve tjera të paraqitura nga pala ankuese, Komisioni nuk gjen prova të cilat vërtetojnë ato pretendime.

Komisioni vlerësoi se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përbaruesin si dhe tek përbaruesit tjerë që t’u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

¹ AC, Nr 2922/2019 dt 19.03.2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 23/2020, datë 30.12.2020

Kryesuesi i Komisionit Disiplinor

Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.